



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2232
Dt 07.11.2019

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 7.11.2019, mori:

VENDIM

- I. Për lidhjen e menjëhershme të kontratës me kandidatin e suksesshëm nga konkursi i shpallur më 13.09.2018, për pozitën: **Një mësimdhënës** për lëndët: Vizatim, Punë dore me modelim, Artet e bukura, në Fakultetin e Edukimit, përkundër afatit të ankesave.
- II. Kontrata e punës me kandidatin e suksesshëm do të lidhet prej datës së nxjerrjes së këtij vendimi.
- III. Kandidatët e pakënaqur rezervojnë të drejtën e ankesave në bazë të dispozitave ligjore.
- IV. Në rast të kontestimit të ndonjë vendimi të Senatit, për zgjedhjen eventuale të kandidatit nga pika I e këtij vendimi, nga instancat më të larta (Inspektorati i Punës apo gjykata kompetente), UMIB rezervon të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës me kandidatin e kontestuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke pasur parasysh se viti akademik ka filluar prej 1.10.2019, dhe procedura e ankesës lidhur me kandidatin e suksesshëm nga konkursi i shpallur më 13.09.2018, për pozitën: **Një mësimdhënës** për lëndët: Vizatim, Punë dore me modelim, Artet e bukura, në Fakultetin e Edukimit, në UMIB ka përfunduar, e konsideroi të arsyeshme që kontrata e punës me kandidatët e përmendur të lidhet menjëherë, me qëllim që kandidati i përzgjedhur të fillojë mbajtjen e mësimit dhe të realizohet me kohë planprogrami mësimor në secilën lëndë mësimore. Bazuar në këtë që u tha më lartë, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Drejtorit të Zyrës për çështje akademike;
4. Zyrës për buxhet dhe financa;
5. Zyrës së personelit;

Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it

